

DITARI MUJOR

QERSHOR 2026



RRITET VIZITUESHMËRIA NË INSTITUCIONET E TRASHËGIMISË KULTURORE

Gjatë periudhës janar–maj 2026, institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore në Shqipëri mirëpritën 424,082 vizitorë vendas dhe të huaj, duke shënuar një rritje të ndjeshme të interesit për kulturën dhe historinë e vendit. Vizitat u shpërndanë mes muzeve kombëtare, parqeve arkeologjike, kalave dhe monumenteve të kulturës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, vizitueshmëria u rrit me 95.7% dhe të ardhurat me 147.4%. Treguesit konfirmojnë rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit dhe promovimin e Shqipërisë si një destinacion kulturor me interes në rritje.

HAPET LINJA DIREKTE TIRANË–TORONTO, HISTORIKE PËR TURIZMIN DHE NDËRLIDHJEN NDËRKOMBËTARE



Shqipëria shënoi një moment historik me hapjen e fluturimit të parë direkt Tiranë–Toronto, duke u bërë për herë të parë pjesë e rrjetit të fluturimeve transoqeanike. Hapja e kësaj linje krijon mundësi të reja për zhvillimin e turizmit, rritjen e investimeve dhe forcimin e lidhjeve me Kanadanë, duke e bërë vendin më të aksesueshëm për vizitorët ndërkombëtarë. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm në zgjerimin e rrjetit ajror të Shqipërisë dhe në konsolidimin e saj si një destinacion turistik gjithnjë e më konkurrues në tregjet globale.

MBLIDHET TASK FORCA PËR SEZONIN TURISTIK 2026

Task Forca Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik 2026 u mbledh në një takim koordinues për përcaktimin e masave që do të garantojnë mbarëvajtjen e sezonit veror në të gjithë vendin. Në fokus ishin siguria në plazhe, menaxhimi i mjeteve lundruese, pastërtia dhe mbrojtja e mjedisit, siguria ushqimore, funksionimi i shërbimeve shëndetësore sezonale, si edhe menaxhimi i trafikut dhe fluksit të vizitorëve në pikat kufitare dhe destinacionet turistike. Përmes bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve dhe zbatimit të koordinuar të masave, synohet garantimi i një sezoni turistik të sigurt, cilësor dhe të suksesshëm, në përputhje me rritjen e vazhdueshme të numrit të vizitorëve në Shqipëri.



SHQIPËRIA MIRËPRET PËR HERË TË PARË KONFERENCËN E KARTËS RINORE EUROPIANE

Në kuadër të zhvillimit për herë të parë në Shqipëri të Konferencës së Kartës Rinore Europiane, u vu në fokus roli i Kartës Rinore Europiane si një instrument që



zgjeron mundësitë për të rinjtë shqiptarë. Karta u ofron përfitime konkrete në transport, udhëtime, akomodim, aktivitete kulturore e sportive, si edhe akses në trajnime, edukim joformal, mobilitet dhe shkëmbime ndërkombëtare, duke i lidhur me një rrjet europian me miliona të rinj dhe mijëra partnerë. Konferenca, me pjesëmarrjen e mbi 100 përfaqësuesve nga më shumë se 30 vende europiane, konfirmoi angazhimin për të fuqizuar pjesëmarrjen e të rinjve dhe për t'i afruar ata me mundësitë që ofron hapësira europiane.



ZBULOHEK NJË KOMPLEKS TERMAL ROMAK NË LUSHNJË

Në fshatin Zgjanë të Lushnjes u zbulua një sit i ri arkeologjik, ku gërmimet e realizuara nga specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me Departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe Bashkinë Lushnje, nxorën në dritë mbetjet e një kompleksi termal të periudhës romake dhe ambienteve të lidhura me të.

Ky zbulim, ndër më të rëndësishmit arkeologjikë në zonë në dekadat e fundit, pritet të pasurojë njohuritë mbi historinë e rajonit dhe të krijojë një atraksion të ri me vlerë për trashëgiminë kulturore dhe zhvillimin e turizmit kulturor.

EKSPOZITA “IKONAT E SHQIPËRISË” PROMOVON TRASHËGIMINË SHQIPTARE NË FRANCË

Në Chambéry të Francës u çel ekspozita “Ikonat e Shqipërisë – Thesaret e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar të Korçës”, një nga ngjarjet më të rëndësishme të diplomacisë kulturore shqiptare. Deri më 13 nëntor 2026, publiku francez do të ketë mundësinë të vizitojë një koleksion me mbi 45 ikona të përzgjedhura nga Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, përfshirë vepra të mjeshtërve si Onufri, vëllezërit Zografi dhe Mësues Kostandini. Ekspozita promovon pasurinë artistike dhe historike të Shqipërisë, duke forcuar prezencën e saj në skenën kulturore europiane dhe rolin e trashëgimisë kulturore si një instrument i rëndësishëm i diplomacisë kulturore.





TURIZMI SHQIPTAR VIJON RITJEN ME MBI 1.1 MILION VIZITORE NË MUAJIN MAJ

Shqipëria vijoi trendin pozitiv të turizmit edhe gjatë muajit maj 2026, duke mirëpritur 1,143,595 vizitorë të huaj, ose 16% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja u mbështet nga zgjerimi i investimeve në infrastrukturën turistike, rritja e kapaciteteve akomoduese, promovimi i destinacionit dhe kalendari gjithëvjeter i aktiviteteve. Kosova dhe Italia mbetën tregjet kryesore të origjinës së vizitorëve, ndërsa interes në rritje u regjistrua edhe nga SHBA-ja, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar dhe tregje të tjera me potencial të lartë. Këta tregues konfirmojnë konsolidimin e Shqipërisë si një destinacion turistik gjithnjë e më konkurrues dhe tërheqës në rajon dhe në tregjet ndërkombëtare.

PREZANTOHET DRAFT-STRATEGJIA KOMBËTARE E KULTURËS 2026–2030



Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit prezantoi Draft-Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2026–2030, dokumentin strategjik që përcakton prioritetet për zhvillimin e sektorit kulturor në pesë vitet e ardhshme. E hartuar përmes një procesi të gjerë konsultimi me institucione, artistë, ekspertë, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë ndërkombëtarë, strategjia synon të forcojë institucionet kulturore, të mbështesë krijimtarinë dhe industritë kreative, të promovojë trashëgiminë kulturore si një motor zhvillimi dhe të zgjerojë aksesin e qytetarëve në kulturë.

Dokumenti u hodh për konsultim publik, duke ftuar të gjithë aktorët e interesuar të kontribuojnë me komente dhe propozime për përmirësimin e tij, në funksion të ndërtimit të një ekosistemi kulturor më modern, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

ZHVILLOHEN DISA INSPEKTIVE NË BREGDET PËR MBROJTJEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Në Plazhin e Malit të Robit në Kavajë dhe në zonën e Lungomares në Vlorë Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit zhvilloi disa inspektive dhe takime me komunitetin, me fokus garantimin e aksesit të lirë në plazhet publike dhe respektimin e rregullave për administrimin e hapësirave bregdetare. Në Kavajë u diskutuan me banorët problematikat dhe nevojat për përmirësimin e kushteve në plazhin publik, ndërsa në Vlorë u konstatuan shkelje nga disa subjekte që kishin zënë hapësira publike me çadra dhe shezlongë, ku iu kërkua lirimi i menjëhershëm i parcelave dhe u paralajmëruan me masa ndëshkuese. Kontrollët e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit do të vijojnë përgjatë gjithë vijës bregdetare për të garantuar zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e hapësirave publike.



VIJON PUNA NË KANTIERIN E QENDRËS KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË

Godina e re e Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë po shkon drejt përfundimit, duke u kthyer në një nga investimet më të rëndësishme për artin, edukimin dhe krijimtarinë e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri.

Me mbi 7,000 m² hapësira funksionale, skenë të dyfishtë të lëvizshme, amfiteatër të hapur, studio krijuese dhe punishte profesionale, qendra do të ofrojë kushte moderne dhe teknologji bashkëkohore për zhvillimin e talenteve të reja në artet skenike dhe krijuese.



PËRMIRËSOHET INFRASTRUKTURA TURISTIKE DHE KULTURORE NË POGRADEDEC

Me rastin e çeljes së sezonit turistik, në Pogradec u zhvillua një takim me operatorët lokalë për të diskutuar përmirësimin e shërbimeve, menaxhimin e plazheve bregliqenore dhe mbrojtjen e mjedisit, ndërsa një fluturim simbolik me hidroplan në itinerarin Rinas-Liqeni i Ohrit u prezantua si mundësi e re për zhvillimin e turizmit dhe ndërlidhjes rajonale. Paralelisht, po avancohet projekti për modernizimin e kinemasë publike dhe integrimin e saj në Rrjetin Kombëtar të Kinemave, si edhe restaurimi dhe rikualifikimi i Qendrës Historike të Pogradecit, ku punimet kanë arritur në rreth 80%. Këto investime synojnë të forcojnë identitetin kulturor të qytetit, të përmirësojnë eksperiencën e vizitorëve dhe të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe ekonomisë lokale.



MIRATOHEN NDRYSHIMET NË LIGJIN PËR TË DREJTËN E AUTORIT

U miratua projektligji për ndryshimet në ligjin “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të kuadrit ligjor dhe përafrimit të tij me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe zhvillimet e ekonomisë digjitale.

Ndryshimet forcojnë mbrojtjen e të drejtave të autorit në mjedisin online, rrisin përgjegjësinë e platformave digjitale, garantojnë shpërblim më të drejtë dhe transparencë për autorët, artistët dhe botuesit, si edhe lehtësojnë përdorimin e veprave për arsimin, kërkimin shkencor dhe institucionet kulturore.

Projektligji synon krijimin e një sistemi më efektiv dhe bashkëkohor për mbrojtjen e krijimtarisë në epokën digjitale.



NIS PUNA E KOMITETIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIMIN RAJONAL DHE KOHEZIONIN

U zhvillua mbledhja e parë konstituive e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin (KKZHRK), organi më i lartë vendimmarrës për koordinimin e politikave të zhvillimit territorial në Shqipëri. Komiteti do të orientojë investimet dhe do të forcojë bashkëpunimin ndërinstitucional për zhvillimin e balancuar të rajoneve, duke mbështetur potencialin ekonomik, turistik, kulturor dhe social të vendit. Në këtë proces, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit do të kontribuojë përmes politikave dhe programeve që nxisin zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e komuniteteve.




KULLA E TURANIT DREJT RESTAURIMIT PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE

Kulla e Turanit, e përfshirë në listën e objekteve në risk të DRTK Korçë pas dëmtimeve të shkaktuara nga reshjet e dendura, do t'i nënshtrohet së shpejti një ndërhyrjeje emergjente restauruese. Punimet do të përqendrohen në konsolidimin dhe restaurimin e monumentit, në përputhje me parimet e restaurimit konservues dhe ruajtjes së autenticitetit, me synim mbrojtjen dhe preservimin afatgjatë të kësaj vlere të trashëgimisë kulturore.



PËRDITËSOHET KUADRI I MBROJTJES PËR QENDRËN HISTORIKE TË DHËRMIUT

Këshilli i Ministrave miratoi kuadrin e përditësuar për mbrojtjen dhe administrimin e Qendrës Historike të Dhërmiut, duke forcuar ruajtjen e vlerave historike, arkitekture dhe kulturore të këtij destinacioni. Vendimi përditëson rregullat dhe procedurat për administrimin dhe konservimin e zonës, pa ndryshuar kufijtë e Qendrës Historike apo të zonës së mbrojtur, me synim garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm në harmoni me trashëgiminë kulturore dhe peizazhin karakteristik të Dhërmiut.



MUZEU ETNOGRAFIK I DURRËSIT RIKTHEHET I RESTAURUAR PËR VIZITORËT

Pas restaurimit të plotë përmes programit EU4Culture, të financuar nga Bashkimi Europian dhe zbatuar nga UNOPS në partneritet me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Muzeu Etnografik i Durrësit është rihapur për publikun. Monument Kulture i Kategorisë së Parë dhe shtëpia e fëmijërisë së Aleksandër Moisiut, objekti u rikthye në funksion pas dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019, duke ruajtur vlerat e tij historike dhe arkitekturore. Muzeu ofron tashmë një hapësirë të restauruar ku vizitorët mund të njihen me trashëgiminë e Aleksandër Moisiut dhe traditat kulturore të Durrësit.

